



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2236 Prot

Lezhë, më 22 / 2 /2023

VENDIM

Nr 12, datë 21 / 02 /2023

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2022

Në zbatim të nenin 54 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

- 1.Miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Lezhë për vitin 2022, sipas pasqyrave dhe raportit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 184/9 Prot.

Lezhë, më 24.02.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijenë : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 22 , datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të njësive të vetëqeverisjes vendore " dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 , datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.12 , datë 21.02.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e buxhetit faktik të bashkisë Lezhë për vitin 2022".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

